

Lidhur me sa kerkoni ju sqarojme se sistemi doganor statistikor operon mbi bazen e Nomenklatures se Kombinuar te Mallrave (<https://www.dogana.gov.al/d/169/182/248/231/nomenklatura-e-kombinuar-e-mallrave>).

Nga kerkimi yne ka rezultuar se nuk ka nje kod te dedikuar per mallin "**Suplemente farmaceutik**".

Nga ana jone u bene kerkime ne sistem me fjalen kyçe "Suplement" dhe "Farmaceutik", si dhe u perdoren per kerkim disa kombinime statistikore te tyre. Nga kerkimi rezultoi se nuk ka import me emertese "suplemente farmaceutike", apo te ngjashem sipas kerkeses tuaj.

Sqarojme se ne deklarimin ne dogane dhe ne Nomenklature (per produktet farmaceutike) nuk ka specifikime per llojin e medikamentit karakteristikave te tij apo principit aktiv. Ne pergjithesi, per qellime doganore - Medikamentet klasifikohen ne Kreret 3003 dhe 3004 te Nomenklatur se Mallrave (KAPITULLI 30 PRODUKTET FARMACEUTIKE) per te cilat tarifa doganore eshte 0 - Pa takse, sipas <https://www.dogana.gov.al/dokument/4323/nomenklatura-2023-vkm-nr883-date-27122022>. (faqe 221-225).

Dogana mund te identifikoj vetem sasine ne peshe dhe ne vlere statistikore te medikamenteve, bazuar ne deklaratat doganore, por se cfare lloji/jesh medikamenti/esh jane eshte ne kompetence te Ministrise Shendetesise, bazuar ne Ligjin nr. 105/2014 "Per Barnat e sherbimin farmaceutik", sipas se cilit verifikimi i barnave të importuara bëhet në prani të inspektorit farmaceutik. Ne kete kuptim sugjerome ti drejtoheni institucioneve te mesiperme te cilat mund tju informojne me hollesisht per trajtimin e kerkeses tuaj, dhe te ofrojne konsulencen e tyre ne lidhje me percaktimin e sakte te kodit tarifar (nese ka).